



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e VI
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 9/17
Prishtinë, më 22.11.2017, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Lumir Abdixhiku, Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontiq, Dardan Molliqaj, Ali Lajqi, Naser Osmani, Mërgim Lushtaku, Blerim Kuqi, Enver Hoti dhe Fikrim Damka.

Mungoi: Mytaher Haskuka.

Pjesëmarrës të ftuar: Bedri Hamza Ministër i MF, Lulzim Rafuna – këshilltar i MF, Salvador Elmazi, Drejtor i Buxhetit në MF, Gëzim Bislimi dhe Milaim Aliu nga MF.

Pjesëmarrës tjerë: Jehona Zhuniqi – Gazetare nga Arbresha Info, Albulena Mavraj - Gazetare Epoka Re, Sanie Jusufi – Gazetare Koha Ditore, Semra Citaku – nga Ambasada Britanike.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi dhe Dashurije Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Kryetar i Komisionit – Lumir Abdixhiku.

R e n d i i d i t ë s

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018;**
- 4. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari – konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, dt. 27.10.2017, 30.11.2017; 31.11.2017 dhe 8.11.2018**

Kryetari – konstatoi se procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura të Komisionit, 27.10.2017, 30.11.2017, 31.11.2017 dhe 8.11.2018, miratohen pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-020 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018

Lumir Abdirxhiku - Projektligji i Buxhetit i Republikës së Kosovës për vitin 2018 është proceduar në Kuvend në pajtim me Ligjin për menagjimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Përveç pjesës tekstuale buxheti përmban edhe pjesën tabelare me të dhënat për shpenzimet e përgjithshme, gjithashtu përmban edhe kornizen makrofiskale për vitin 2018-2020, që pasqyron të dhënat për rrjedhat makroekonomike aktuale, për treguesit makroekonomik dhe trendin e të hyrave dhe shpenzimeve si dhe ndikimet ekonomike në periudhën afatëmesme.

Të hyrat e rregullta buxhetore të rregullta për vitin 2018 janë 1.829 milion euro, ndërsa shpenzimet në vlerë prej 2.082 milionë euro, përveq të hyrave të rregullta janë planifikuar edhe të hyra nga huadhënia përmes klauzolës së investimeve prej 62.11 milionë euro dhe të hyrat nga likuidimi i agjensisë kosovare të privatizimit në vlerë prej 31 milionë euro. Deficiti buxhetor planifikohet të jetë 1.7%.

Bedri Hamza - si bazë për përgaditjen e këti projektbuxheti është marrë program i qeverisë dhe për më shumë kemi marrë për bazë konceptin makroekonomik të brendshëm dhe të jashtëm. Sipas projeksioneve për vitin 2018 presim që rritja ekonomike e vendit e matur përmes rritjes së brutoproduktit vendor të jetë 4.6% në terma reale, ndërsa në ato nominale rritja do të jetë në 6%. Në periudhën afatëmesme rritja reale pritet të jetë edhe më e lartë në një mesatare vjetore rreth 5%.

Kjo rritje e projektuar pritet të mbështetet në të gjitha nga niveli i rritur i investimeve duke përfshir edhe ato publike, konsumi dhe rritja e eksporteve të vendit. Këto projeksione nuk marrën parasysh efektin e mundshëm të projekteve të mëdha që mund të implementohet në periudhën afatëmesme, siç është rasti i Kosovës së re dhe projektet e ngjashme.

Për sa i përket çmimeve në vitin 2018 dhe viteve vijuse pritet një stabilitet i theksuar ku inflacioni është projektuar të jetë rreth 1% në baza vjetore.

Projeksionet mbi të hyrat janë të ndërtuar mbi bazën e parashikime për zhvillimet gjithëmbashme ekonomike dhe efektet e zhvillimeve në bazën tatimore. Duke u mbështetur në këto parime në presim në vitin 2018 të hyrat në total të buxhetit të jenë 1.829 milionë euro e cila është më e lartë se rishikimi i buxhetit 2017 për rreth 6% apo 104 milion euro. Rritja e të hyrave të përgjithshme vjen si rezultat i kontributit prej 74% e tatimeve indirekte, të pasuara me 15% tatime direkte dhe rreth 11% të hyrave jotatimore. Të hyrat nga ATK-ja pritet ta arrinë vlerën në 446 milion euro që është një rritje 5.4% në raport me buxhetin e rishikuar të vitit 2017, ndërsa të hyrat e mbledhura nga Doganat e Kosovës, planifikohen të arrinë në 1.175 milionë euro apo një rritje 6% krahasuar me vitin 2017. Sa i përket të hyrave tatimore ato priten të arrinë vlerën prej 200 milionë euro.

Gjithsej shpenzimet buxhetore janë rritur për 272 milion euro apo me 15% nga buxheti i vitit 2017, duke arritur shumën totale prej 2.082 milion euro. Shpenzimet për paga dhe mëditje janë paraparë të jenë 589 milion euro, një rritje prej 4.3% në raport me rishikin 2017. Si pjesëmarrje e brutoproduktit vendor kjo kategori e shpenzimeve paraqitet me trend pozitiv nga 9% në buxhetin vitit 2017, dhe 8.9% e buxhetin e vitit 2018. Në këtë kategori parashihet po ashtu rritja e pagave për të gjithë të punësuarit në sektorin publik nga 1 janari i vitit 2018, si edhe pagat për rritjen e punësimit për sektorin strategjik të vendit.

Subvencionet dhe transferet pritet të arrinë në vlerën prej 525 milion euro, që është një rritje prej 6% në krahasim me buxhetin e rishikuar 2017. Si pjesëmarrje e brutoproduktit vendor pritet të arrinë në nivelin prej 7.9%, sa ishin në vitin 2017.

Me këtë buxhet pritet të financohen gjitha skemat shoqërore sa i përketë përfshirjes së kategorive të dalura nga lufta, rritjen e buxhetit për përfituesit nga skemat sociale, financimin për trashëgimin

punëdhënësit etj. Përmes buxhetit për transfere sociale do të mbështetën edhe viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës së fundit, si dhe përkrahja e fermerëve.

Shpenzimet për mallra dhe shpenzime priten të rriten si rezultat i shpenimeve paraprake për projektet kapitale dhe nevojës për mirëmbajtjen e tyre, dhe ato priten 264 milionë euro, apo një rritje prej 7.9% në raport me rishikimin e buxhetit 2017. Shpenzimet kapitale planifikohen të rriten për 37% në raport me buxhetin e rishikuar të viti 2017 duke arritur shumën 687 milionë euro.

Pjesë e rëndësishme e investimeve kapitale janë projekte e autostradës Prishtinë-Shkup, autostrada Prishtinë-Gjilan, projekti i rrugës M2 për Mitrovicë, M3 për Pejë dhe rruga për Podujevë, përfundimi i ndërimit të rrugës Skenderaj-Drenas, zgjerimin e rrugës në Gjakovë.

Projektet e cila kanë qar një rritje të ndjeshme, në kuadër të financimit përmes klauzolës së investimit ne kemi përfshirë vetëm projektin për cilën kanë përgaditjet e duhura dhe këtu ka interesim të instucioneve financiare ndërkombëtare për financim. Trajtimi i ujrave të zeza do të ketë një prioritet ku gjatë viti që vjenë pritet të jetë edhe projekti për kryeqytetin Prishtinën, Fushë Kosovën dhe Obiliqin.

Nga gjithësej rritja e shpenzimeve 50 milion euro janë të dedikuara për rritjen e shpenzimeve të buxhetit në nivel komunal, në total shpenzimet për financimin e buxheteve komunale janë planifikuar të jenë 491.2 milionë euro. Rritja e grantit të përgjithshëm rreth 30 milion euro, në krahasim me buxhetin e rishikuar të viti 2017, duke shkuar në 179.4 milionë euro në total. Granti për arsim ka një rritje prej 6 milionë euro duke shkuar në 169.3 në total. Granti për shëndetësi një rritje prej 4 milionë euro apo totali prej 48 milionë euro. Po ashtu buxheti komunal është rritur për 3 milionë euro nga rritja e planifikuar e të hyrave vetanake prej 3.3 milione euro nga shfrytëzuesit e huamarrjes në shëndetësi dhe në arsim.

Shpenzimet për funksionin e drejtësisë dhe të mbrojtjes dhe sigurisë publike, janë 246 milionë euro, Ministria e Drejtësisë po ashtu parasheh rritje 9%, Këshili Gjyqësor i Kosovës një rritje prej 12% dhe Këshilli Prokurorial i Kosvoës për 27%, Akademia e Drejtësisë për Ndihmë Falas po ashtu ka përfitu buxhet shtesë dhe ka marrë mbështetje me 13% krahasim me vitin 2017. Kemi një rritje prej 690 pozita më tepër në Këshillin Gjyqësor dhe në atë Prokurorial. Sektori i mbrojtjes dhe i sigurisë publike, ministria e brendshme e FSK-së dhe AKI-ja është rritur gjithashtu me 13% duke lejuar që të ketë përbrenda efikasitet më të lartë përbrenda këtij sektori.

Për Ministrin e Shëndetësisë dhe Shërbimin Spitalor Universitar, ndarjet buxhetore priten të rriten për 21% në nivelin qëndror, veq kësaj ka edhe granti komunal për rritje në shëndetësi është rritur për 9%. Në të njëjten kohë është ndarë edhe kontigjent shtesë për fillimin e implementimin të sigurimeve shëndetësore nëse ecet me implementimin e aktëve nënligjore dhe gjitha procedurat tjera që duhet të kryhen. Për herë të parë buxheti për vitin 2018 ka sjellë gjithsej për financimin e shëndetësisë prej 200 milionë euro. Ndarjet për barëra esenciale janë rritur me 36% krahasuar me vitin 2017, është siguruar edhe pagesë për specializantët, për më shumë është siguruar edhe mbështetje për financimin 200 mjekëve specialist dhe 100 infermerëve të rinjë shpenzimet kapitale për këtë sektor në raport me rishikimin e buxhetit 2017 është rritë për 126%.

Ndarjet buxhetore për sektorin e arsimit, ministria e arsimit, universitetet publike dhe akademinë e shkencave është rritur për një mesatare për 22% në nivel qëndror duke llogaritur edhe rritjen prej 4% grantet komunale për arsimë totali i shpenzimeve për arsim planifikohen të jenë për 260.2 milionë euro.

Për infrasrukturë dhe konkurrenshëri ekonomike ndarjet buxhetore janë rritur me 32.8% krahasuar me rishikimin e buxhetit të vitit 2017 duke arritur vleren prej 374 milionë euro. Në anën tjetër është rritur edhe për 9% mbështetja financiare për bujqësinë duke arritur financimin në total prej 60 milionë euro. Në total buxheti i viti 2018 parasheh shpenzimet direkte në vlerë prej 434 milionë euro.

Deficiti i përgjithshëm publikë për vitin 2018 pritet të jetë -112 milion euro apo 1.7% e bruto produktit vendor. Natyrishtë kur këtij deficit i shtojmë edhe financimin për kaluzolën e investime dhe nga mjetet e AKP-së. Financimi i deficitit pritet të kombinohet me një huamarrje të jashtme dhe asaj të brendshme.

Lumir Abdirxhiku – unë do të ndajë diskutimin në dy pjesë, në pjesën e parë do të flasë si ekonomist dhe do të japë këshilla në pjesën makroekonomike dhe që besojë se kalojnë edhe bindjet politike dhe në pjesën e dytë do flasë në aspektet politike të buxhetit.

Për mendimin tim është vlerë pjesa e analizës makroekonomike por gjithësesi kam përshtypje se është tepër gjenerale, pra nuk e kemi të qartë se çka ndodhë me rritjen e një investimi të caktuar ekskluzivisht prej financimit prej buxhetit, jo prej rrjedhave ekonomike në përgjithësi. Unë besoj se kësaj analize i mungon analiza e ndjeshmërisë, pra çka ndodhë me të hyrat buxhetore nëse GDP-ja zvoglohet për një 1.% ose nuk arrihet të realizohet për 1%.

Një qëstje tjetër është një metodologji e llogaritjes së GDP-së, po ajo duhej të bëhej publike me një punim të veçantë jashtë buxhetit në mënyrë që ta kemi më të qartë një pjesë se si po arrihen këto të hyra të pjesës makroekonomike që janë të rëndësishme së veçantë. Do pasurohej kjo pjesë sikur të jepeshin të dhëna historike, sikur të jepeshin ndarje të rëndësishme sipas klasifikimit ndërkombëtar sipas instucioneve të qeverisë, pra nëpër vite se qfarë ka ndodhë me shpenzimet nëpër këto funksionet për të pasur një pasqyrë më të qartë se qfarë po ndodhë edhe me risit e buxhetit por edhe projeksionet në të ardhmen.

Gjithashtu mungon edhe analiza e disagreguar për nivele tjera p.sh. sa jepet në edukim primarë si shumë totale ose si edukim sekondar apo sa jepet në tericar edhe në funksionet e tjera. Mendoj se i mungone dhe analiza mbi vendimet e reja të qeverisë, pra një pjesë si seksion i veçantë qka ka sjellë të re qeveria në buxhetin që është në vijë me kornizen afatemesme ose çka është risi e këtij buxheti dhe a ka adresim të prioriteteve sipas dokumenteve kryesore nacionale që ka Kosova, ku është ndërlidhshmëria.

Një qëstje po ashtu politike tek lufta kundër informalitetit është përmendur diku në analizen makroekonomike por nuk e shoh qartë se çka reflektim në shtimin e të hyrave. Në fakt analizova të hyrat që janë planifikuar 6.3% në vitin 2018, por trendi rritjes i të hyrave është më i ulët sesa i viteve paraprake, p.sh. krahasova vitin 2015 që ishte 9.3%, në vitin 2016 ishte 9.4%, në 2017 është 7.3 %. Pra nëse tre vitet paraprake kemi pasur rritjen të të hyrave në trend me 9% dhe mesatare tani i kemi 6% dhe nëse ka luftë ndaj informalitetit ishte dashur me qenë shumë më e lartë ky trend i të hyrave. Kishte qenë mirë që pjesa makroekonomike të na tregoj se sa ka me u zvoglu informaliteti, sa do të zvogëlohet evazoni fiskal dhe qfarë ndikime në margjinën shtesë do të jetë tek pjesa e të hyrave.

Sa i përket rritjes ekonomike prej 4.6%, kjo rritje është në kundërshtim me premtimet elektorale siç qeveria i ka dhënë që ka qenë 8 deri në 10% dhe është në kundërshtim edhe me programin qeverisës ku thuhet se rritja ekonomike do jetë deri në 8% deri në tri vitet e ardhshme. Këtë rritje ekonomike nuk po e shohë as në buxhet në tre vitet e ardhshme të paraparë në kornizën makrofiskale. Buxheti mund të reflektojë prioritetet e qeverisë, por unë kam problem me këto prioritate, besojë se pajtohem gjithë se buxheti është shëndrruar në një mjet financimit të luksit publik, siç janë 22 ministri, 70 zv.ministra, me 200-300 këshilltar shton më tepër barrën fiskale në buxhet, dhe unë besojë që e para e punës që duhej bërë është nisja e programit të kursimit të parasë publike.

E dyta besoj se prioritet i gabuar i qeverisë është fokusimi apo vazhdimi i fokusimit në asfalt, diku rreth 41% e investimeve kapitale shkojnë në asfalt, edhe se pse është i domosdoshëm financimi i rrugës për Prishtinë, Gjilan, M2 për Mitrovicë, M3 për Pejë, për Podujevë, por besoj se qeveria ish dashtë që të ishte më kreative të gjejë formë alternative të financimit të këtyre rrugëve në mënyrë që këto para ti përdorim në nevoja tjera dhe për prioritate tjera të qytetarëve.

Pagat do rritën për 3.5% dhe atë do ta merrë premiumet shëndetësorë në efektin neto në sektorin publik do mbetet i njëjtë, po në sektorin privat qytetarët do kenë më pakë para.

Buxheti është rritë në 200 milionë euro, por në margjinë prap është pak, nuk është transformues, pra nuk e trajtojmë shëndësinë siç e kemi trajtu asfaltin në dhejtë vitet e fundit.

Prap është funksioni i arsimit dhe besojë e rezultatet e PISA-së na kanë hapë sy pakëz dhe se ne po prodhojmë një gjeneratë të humbur dhe kotë prodhojmë asfaltë, kot ndërtojmë edhe shkolla nëse nuk kemi transformimi radikal në sektorin e sistemit arsimor. Për mua është shqetësuese se çka ka mendu ministria e arsimit kur e ka reduktuar shkurtimin buxhetor për zhvillimin e mësimdhënsve për 45%.

Investimet kapitale kanë njëfarë doze të rajonalizimit. Për në Prishtinë në projektet kapitale për nivelin qëndror i gjeta vetëm pesë projekte, që kapin vlerën totale në më pak se 5 milionë euro. Por se Prishtina jepë buxhetit Kosovës më se 600 milion euro në vit kontribut dhe për tre vitet e ardhshme jepë rreth 2

miliard euro dhe nëse merr 5 milionë euro në vit, përveç grantit qeveritar që kalon nëpër komuna, besoj se është disproporcional.

Kritika ime shkonë natyrisht edhe për çështjen e pensionerëve të veteranëve sepse 58 milionë euro nuk është shumë e plotë sepse kalkulova 3700 veteranë nga 170 euro duhet të jenë 78 milionë euro pra neve do duhej të shtojmë edhe 20-30 milionë euro në rishikim buxhetor, përveç kësaj shume për të arritur në 80 milione euro.

Kritik tjetër është edhe projektet për mbrojtje, shihet që projektbuxheti parasheh investimet për mbrojtje për transformimin e FSK-së në ushtri, shuma prej 60 milionë euro është më pak se 1% e GDP-së. Nëse e transformojmë FSK-në në ushtri neve do të duhej ti kemi rreth 2% mjete te GDP-së në mjete financiare dikun 120 milion euro vetëm për FSK-në. Mjetet e RTK-së, unë jam kundërshtari i dhënies së 11 milion euro për RTK-në, ndërsa dhënies së buxhetit për inspektoriat të punës 7-8 milion më pak.

Blerim Kuçi – unë do të ngris tri çështje që kërkohet më tepër sqarime nga ministri. Elementi i parë ka të bëjë me sektorin e sigursë edhe mekanizmat që kanë të bëjnë me integritetin dhe nacionalitetin e shtetit, qoftë FSK-ja, Policia, Diplomacia dhe gjitha mekanizmat e sigurisë, kërkohet pakëz sqarime shtesë lidhur me rritjet buxhetore dhe çka ato rritje prodhojnë?

Elementi i dytë që nuk e kam pa në buxhet ose është e future në disa kode është çështja e një programi të veçantë për punësimin e të rinjëve e sidomos në ata biznesbërje për të rinjët. Ne gjithë flasim për programin e moslëshuerjes nga Kosova, kurse program veçantë me këtë buxhet nuk kemi.

Elementi i tretë është çështja e sigurimit shëndetësorë edhe pse ne kemi pasur debate në këtë komision edhe në Kuvend, buxheti që është paraparë për vitin 2017 diku 17 milionë euro nuk e pash që figuron në një kod të caktuar, pse nuk është apo ka të bëjë me gjetjen apo me mospregaditjen e mekanizmave tonë për me përcjellë programin më sigurim shëndetësor?

Kryetari i komisionit përmendi një element me të cilin unë nuk pajtohem, për të cilin tha se trendi i të hyrave është 6.3% dhe është më pak sesa në projektimet e buxhetit të vitit 2015, në fakt është ma pak por në 2015 kemi pas një rritje të tatimit, kemi pasur 12% rritje të tvsh-së edhe atëherë nuk ka qenë prej rritjes së të hyrave.

Lumir Abdirxhiku – faleminderit zotri Kuçi, sa për një sqarim nuk kam thënë rrugët nuk duhet me u ndërto, por kam shprehur mendimin se duhet të gjejmë format të financimit jashta buxhetor. Jemi për rrugë po mënyra e pageses duhet të jetë tjetër.

Blerim Kuçi – sa i përket pjesës hyrëse të buxheti kam përshtypte se kjo është vazhdimësi e kornizave të UNMIK-ut, dhe ne duhet ta ndërrojmë këtë qasje sepse duhet të jetë i përshkruar për këtë çka prodhojmë me buxhet.

Dardan Molliqaj – më lejoni që edhe unë të filloje leximin e draftbuxhetit me një kritik shumë të rëndësishme sepse është asgjë ndryshe prej buxheteve tjera përveq shifrave, pra nuk ka asnjë logjikë ndryshuese prej buxheteve paraprake, pra njëlloj ndryshimi mes matmatikes edhe kontabilitetit asgjë sa i përket ekonomisë.

Përkundër tentimit të ministrit me fut çështjen e diskutimeve makroekonomike, dhe në këtë drejtim pajtona me zotëri Abdixhikun sepse kjo është sipërfaqësore dhe tenton me menjëherë këtë çështje, pra unë nuk kamë parë se si investimet tona kapitale të ndikojnë në rritje ekonomike.

Parashihet një rritje ekonomike dhe ndonëse flitet për konsum, por a është konsumi vendor apo është i huaj, përgjigjen po e shoh në mënyrë indirekte që është i huaj për shkak se projektimi i të hyrave po shihet se janë prej ku është parapar rritja kryesore e të hyrave kshu që është një problem.

Problemi i dytë është sikurse qeverija e kaluar që ka paraparë një rritje kolosale të buxhetit prej 2 miliard euro edhe kjo qeveri përbën një shifer prej mbi 2 miliardë euro për cilën sot po e themë publikisht që me rishikimin e buxhetit prap do të zvogëlohet.

Ajo që më duket shumë problematike se i përket strukturës së buxhetit, në veçanti sa i përket strukturës së të hyrave parashihet rritje sa i përket tvsh-së të grubulluar në doganë me detyrimet doganor. Sa përket rritjes së tillë është e padobishme, e parëndëshishme dhe e papërfillshme për rritjen e mirqenies së qytetarve të Republikës së Kosovës, dhe nuk shoh ndonjë përmirësim përkundrazi jam i shqetësuar me këtë mënyrë se si është strukturuar kjo çështje.

Një temë tjetër që dua ta ngris është çështja e shfrytëzimit të mjeteve nga procesi i privatizimit, ajo që duhet me theksu është se ku shkojnë këto para sepse rreziku është se prapë këto shkojnë në ndërtimin e rrugëve.

Ministri ka shpjegim ekonomik që këto investime në masën mbi 40% kanë rritje ekonomike, e nëse jeni fiksi vetem në tender edhe në qështje ndërtimit të asfaltit. Mos harroni që vetem 1/3 e rrugës së kombit shfrytëzohet, a keni bërë ndonjë analizë se sa do jetë e shfrytëzueshme autostradat që po ndërtohen për Pejë, Gjilan e Skenderaj? Ndoshta është mirë që rrugët që po ndërtohen në Dukagjin më mirë është që të bëjmë rrugën Deçanë- Plavë dhe unë besoj që ka me pas më shumë rritje ekonomike, shumë më shumë do ta zhvillojë edhe turizmin edhe mobilitetin me një shtet tjetër edhe ndoshta vende të punës sa i përket asaj pjese.

Ajo që po e shohë për herë të parë është rritja e deficitit buxhetor prej 86 milion në 253 milionë euro.

Kamë një pyetje ndoshta jo vetëm për ministrin por edhe për Naserin dhe Safeten se janë tre komuna Kosovës që nuk e kanë miratu buxhetin dhe me ligj ishë e paraparë që nëse nuk miratohet në asamble komunale që të përsëritet buxheti sipas vitit që ka pas më herët dhe kam dëgju që ka pas praktika tilla që ti jepet shansi të dytë që të miratohet në asamble dhe të pasqyrohet në buxhet.

Një çështje që është e rëndësishme neni 2 thotë dispozitat e këtij ligji janë të detyrueshme për të gjitha instucionet përbrenda Republikës së Kosovës, ministër nuk kemi paraparë fondin për veriun pra nuk e dimë sa pare po i jepim, cilat projekte po shkojnë dhe nuk është pjesë e buxhetit të Republikës së Kosovës. Sipas leximit që unë i bëj ligjit dhe në atë që kam konsultue me ekspertët ligjor është duke u bërë një shkelje e Ligjit për financa publike dhe kjo është shkelje e sovranitetit dhe integritetit territorial po edhe aspektit financiar.

Një gjë tjetër me rëndësi është neni 7 që ka të bëjë me të hyrat vetanjake të nivelit qendror, ku thuhet që nëse ato depozitohen të hyra vetanake më shumë se alokimet për këtë vit atëher të njejtat bëhen të hyra të përgjithshme dhe mendoj që duhet të klasifikohen nuk jam për secilin rast të bëhet i njëjtë. P.sh. i për rastin e QKUK-së dhe Universtitetin Publik duhet me i'u leju me i përdor për vete sepse janë instucione me rëndësi.

E ngriti kryetari i komisionit, çështjen e financimit të RTK-së, përveç problemeve se si është menagju me atë qka kamë parë tek infrastruktura ligjore ne nuk kemi obligim ligjore për financimin e RTK-së, dhe po më duket që jemi duke bërë gati mënyrë të kundërligjshme.

Ju zoti ministër theksuat se janë shtuar 680 të punësuar në sektorin e drejtësisë dhe mendoj se ka nevojë për staf shtesë, por në tabelen që kemi në sektorin publik rritet për 1070 numri i të punësuarve pra dikun edhe për 45% të këtyre të punësuarve, nuk e dimë ku janë dhe pse kanë qenë këto nevoja, edhe pse në raportet vendore e ndërkombëtare flitet për administratën në Kosovë që është e stërngarkuar?

Lumir Abdirxhiku – Faleminderi zotëri Mulliqaj, sa për informim për pjesen të fondit të veriut kam kërkuar një hulumtim dhe më pas do kemi një takim të veçantë vetëm për fondin e veriut.

Naser Osmani – Si e trajtojmë buxhetin se si e shikojmë krejtësisht varet prej pozicioneve tona sepse opozita e shef gotëm si gjysëm të zbrazët, ndërsa pozita thotë së është gjysëm e plotë. Buxheti që është para neve gati është identik sikurse buxheti i vitit të kaluar vetëm se ndryshojnë numrat, qoftë më vogël apo qoftë më të mëdha në bazë të përgjegjësive të instucioneve përkatëse. Sa i përket pjesës tekstuale tek neni 13 paragrafi 3 ku parasheh për paradhënie të kërkohet edhe pëlqimi i komisionit për buxhet dhe financa që konsideroj se komisioni nuk është mirë me u përzi në çështjet ekzekutive dhe me qenë ombrellë e qfardo tenderimi apo pagese me paradhënie dhe konsideroj që këtë rregullon më mir ligji për prokurimin publik.

Sa përket shpenzimeve një rritje prej 81 milion, ministër mendoj që edhe kjo është një planifikim optimal po ajo çka është brengosëse është rritja që po ndodh kryesisht në shpenzimet në një shumë kaq e madhe prej 589 milion dhe keni parasysh këtu kemi kryesisht pjesën pasive të shpenzimeve, pjesa që merr mjetet nga subvencionet, nga pagesat e astiençave sociale dhe kjo vetëm është ngarkesë e madhe. Sa përket prioritetëve dhe shumave të ndarë nëpër sektor janë në harmoni me politikën dhe prioritetet e qeverisë.

Ali Lajçi – theksoi se ky buxhet duhet të parë në nivelet e konkurrencave partiake dhe programeve të partive të cilat marrin Qeverinë. Zakonisht buxhetet e tilla qfarë janë tashti janë buxhete ekzistuese në një mënyrë dhe me ndonjë rifreskim në disa prej kapitujve financiar. Ne nuk kemi bërë mundësinë që të bëjmë një sistem të kalimit prej burimeve kryesore të buxhetit siç është Dogana që ka mbetur ende fuqia kryesore dhe të kaloj në zhvillimet e sistemeve të brendshme të Kosovës siç janë si psh: zhvillimi i sistemeve, regjistrimi i pronave tatimore e doganore etj., për të cilat jemi larg në atë trend.

Ky fond ose ky vëllim buxhetor faktikisht tash për tash nuk mund të ndërrohet por do të shikojmë vetëm a është racionalizuar dhe a është planifikuar mirë me shpenzimet.

Ne nuk e kemi edhe një ligj të Qeverisë që është i domosdoshëm, dhe kemi numrin e madh të ministrive, zv.ministrave dhe zv.kryeministrave, që është shumë e gabuar dhe e qartë.

Çështja e zhvillimeve infrastrukturore dhe ndarja e buxhetit për këto qëllime është një çështje që duhet dhe është strategjike-zhvillimore dhe mundësi e thithjes e investimeve për shkak se krijon një infrastrukturë dhe jemi shumë dakord, por çështja është krejt te menaxhimi i atyre parave. Çështja e veteranëve të luftës pothuajse përfshinë një kapituj të mirë të buxhetit, ne jemi dakord që ky kapituj të përfundojë me një pajtim me ligjin. Është e rëndësishme shtimi i buxhetit në sektorin e bujqësisë sepse është e nevojshme dhe nuk është e mjaftueshme. Programet e Qeverisë janë të njëjta me programet tash e dhjetë vjet në një trend të njëjtë dhe ndryshimet në nivel buxhetor e administrativ në Kosovë nuk po ndodhen dhe mos kërkon befasi edhe me buxhet.

Enver Hoti - mendoj që është një projektbuxhet i paraqitur në formë të qëndrueshme dhe standarde. Sa i përket shpenzimeve sipas funksioneve, përfshirë ato për Këshillin gjyqësor dhe Këshillin prokurial, dhe te sektori i sigurisë, mendoj që do të duhet një mbështetje dhe rol i veçantë në luftimin e informalitetit e cila krijon mundësi shtesë në të hyra në të ardhmen. Konsideroj që prioritetet e vërteta të kësaj Qeverie do të fillojnë në planifikimin e vitit 2018 dhe në vitin 2019. Ne duhet ti qasimi zhvillimit ekonomik sepse këtu duhet ta ndërprejmë ato që ju z. kryetar i potencioni si ngecje dhe me të vërtetë besoj që do të mbyllet ajo harta e rrugëve dhe nuk po them harta e asfalleve. Ne do ta japim kontributin tonë vazhdimisht në pjesën tjetër ku do të kemi rast edhe të votojmë projektbuxhetin për vitin 2018.

Fikrim Damka – theksoi se disa herë kur e kemi diskutuar për buxhetin e Republikës së Kosovës gjithmonë ne si komunitetet tjera kemi dhënë vërejtje për ndarjen e buxhetit për komunitetet, sidomos për ato jo shqiptare dhe jo serbe. Sipas projekteve të buxhetit kemi dy kategoritë të përfshirë gjithë komunitetet, kategoria e Ministrisë së Komuniteteve për Kthim edhe është kodi brenda Kryeministrit i cili e parasheh 1.2 milionë euro për ndarjen e buxhetit për komunitetet në tërësi. Disa herë kemi bërë amandamente për ndarjen për secilin komunitet dhe e kemi parë në buxhet me kodet e veçanta për secilin komunitet por nuk ka qenë e realizueshme. Ma vonë për të ndërprerë këto keqpërdorime vetëm për një komunitet e kemi futur në buxhet tekstualisht nën 12 ku sot ne nuk mund të shohim atë nën në këtë buxhet. Ky është një shqetësim për neve dhe ky nën nuk ka qenë funksional dhe nuk ka funksionuar asnjëherë por ka qenë një barrierë ku e ka ndaluar Ministrin mos të harxhohen paratë kot pa projektet.

Tashti po shohim që edhe në Ministrinë e Komuniteteve për Kthim është paraparë një kod ku thuhet projektet për komunitetet 500.000 euro, por nuk janë të definuara projektet konkrete për asnjë komunitet.

Deri tani në asnjë vit komunitetet nuk kanë marrë prej këtij buxheti të kësaj ministrie asnjë përqind. Psh

komuniteti turk për vitin 2015-2016 i ka marrë gjithsej 4000 prej Ministrisë dhe mos të flasim edhe për komunitetet tjera që jetojnë sidomos komuniteti RAE që jetonë në një varfëri, ndërsa në këtë Ministri harxhohen parat kot për disa çështje të cilat mund të themi nuk janë as projekte përkthyme e as projekte konkrete.

Po ashtu nuk kam mundur të shoh që në këtë buxhet, zyrat e komuniteteve në secilin komunë që e kanë një projekt ose që e kanë mjete të ndara për subvencione apo për investime kapitale. Të vetmën që e kam parë është Zveqani që janë paraparë 100.000 euro për investime kapitale për komunitetet dhe ne nuk e dijmë se kush janë ato komunitete dhe kush jeton në Zveqan dhe qfar shumicë jeton aty. Prandaj Ministër kërkojmë që të kemi qasje të barabartë prej komuniteteve tjera për buxhet në të kundërtën ne si komunitet jemi të involvuar në këtë buxhet.

Safete Hadërgjonaj - ne që e kemi parë një kontinuitet të planifikimit buxhetor ndoshta për vitet e tëra sot mund ta themi lirisht që ne sot e kemi një draft buxhetor të projektuar teknikisht të përgaditur mirë. E kemi një draftbuxhet që në veti përmban të gjitha kërkesat të cilat i parasheh ligji sipas menaxhimit të financave publike, d.m.th. duke filluar nga treguesit makroekonomik brenda dhe jashtë vendit, mandej trendin e planifikimit të hyrave dhe të shpenzimeve bazuar në treguesit makroekonomik.

Neve na kujtohet që vitin e kaluar buxheti në komision ka ardhur pa treguesit makroekonomik, dhe ishte dashtur me kërku si komision me ju bashkangjitur ky material dhe me vazhdu buxheti në seancën plenare.

Planifikimi i buxhetit është i bazuar në shifra reale, si në planifikimin e të hyrave, po ashtu edhe të shpenzimeve. Nëse i marrim dhe i shohim rrjedhën e rritjes së buxhetit në sektorët ku ka lëvizje pozitive atëherë shohim që buxheti është i harmonizuar mjaftë mirë me politikat qeveritare si dhe me strategjinë kombëtare të zhvillimit dhe projektligji ka marrë parasysh marrëveshjen për asocim dhe stabilizim.

Klauzola e investimeve tani është e planifikuar në shifra reale sepse janë paraparë mjetet vetëm nga marrëveshjet të cilat praktikisht janë të miratuara, kurse tek të hyrat që i kemi pasur shqetësim gjatë vitit të kaluar kanë qenë se nuk ka qenë i miratuar Ligji për Agjencionin e Privatizimit tani e kemi këtë ligj dhe janë të realizueshme.

E vlerësojmë shumë sidomos rritjen e buxhetit prej 13% në sektorin e drejtësisë, ku parashikohet rritja e stafit të profesional gjyqësor, prokurial si dhe rritja e buxhetit për FSK-në dhe për Agjencionin Kosovar të Intelejencës.

Tek sektori i shëndetësisë ne kemi një rritje të mjeteve për 21% në nivelin qendror, kurse 9% për grantet komunal të shëndetësisë. Janë paraparë rritje për barnat esenciale për 36% më shumë, kurse punësimi dhe pagesa së specialistëve dhe specializantëve është një gjë që duhet vlerësuar sepse me këtë problem jemi ballafaquar që dy vite dhe tani e tutje shohim në buxhet është rregulluar. Rritja e shpenzimeve kapitale nga 10 në 24.6 milion po ashtu është bërë në Ministrinë e Shëndetësisë. Nëse e marrim dhe e analzojmë me detaje projektbuxhetin shohim që ka rritje të buxhetit edhe kur kemi të bëjmë me qeverisjen e mirë.

Rritja e buxhetit për agjencionin e anti-korrupsion, komisionin rregullativ të prokurimit publik dhe organi shqyrtues të prokurimit publik, po ashtu besoj që është diqka pozitive që kanë ndodhur në buxhetin e këtij viti. Po ashtu kemi rritje të buxhetit në kulturë për 36% që e kemi pasur një problem dhe është diskutuar me vite të tëra që të kemi një qasje më pozitive në këtë drejtim.

Ne e dijm që Ministria e Financave bën përmbledhjen e të gjithave projekteve prioritare të cilat i kanë në ministritë, komunat dhe institucionet e pavarura, dhe ne e kemi mundësinë këto intitucione, dhe ti diskutojmë dhe të na shpjegojnë për efektshmërinë që presin të arrijnë ata përmes këtyre mjeteve.

U diskutua shumë për orientimin e investimet kapitale dhe ne këtë shqetësim e kemi pasur edhe gjatë mandatit të kaluar dhe unë e konsideroj që secila komunë dhe secili vend në Kosovë është prioritet dhe duhet të jetë prioritet i Qeverisë.

Më vjen mirë për ndarjen e mjeteve për rrugën Deçan-Plavë, dhe financimin e saj në afatin tre vejqar dhe uroj që ajo rrugë të realizohet dhe në njëfarë mënyre edhe po i përmbyllim këto rrugët me interes

nacional të cilat po konsiderohen secila në mënyrën e vet që ka dhënë efektet e mira edhe Kosovës si shtet por edhe për zhvillimit ekonomik.

Mërgim Lushtaku - projektligji i vitit 2018 është hartuar me standardin më të mirë dhe duke u munduar të planifikojë më së miri kërkesat e organizatave buxhetore dhe duke i priorizuar ato qysh është më së miri. Më lejoni të theksoj që edhe unë jam i pajtimit që duhet të ketë një buxhet të dedikuar për ndërmarrësit e ri dhe për bizneset e vogla dhe të mesme ku do të parashihen edhe në punën e granteve mbështetja e ndërmarrësve të ri ku besoj që do të zvogëlohet papunësia.

Vlerësoj shumë lart rritjen e buxhetit të shëndetësisë ku ma herët ka qenë 10 milionë e tani ka vazhduar 24 milionë dhe është zgjedhur çështja e specializantëve që ka mbetur e pazgjidhur në qeverisjen e ministrisë së kaluar dhe besoj që shumë shpejtë do të rregullohet çështja e shëndetësisë dhe do të ketë një përmisim në këtë sektor, pasi që është lënë në harresë për shkak se kemi pasur prioritete më të larta në aspektin e investimeve kapitale duke e rregulluar edhe siguruar që investorët e huaj të kenë mundësi më të mira për investime në Kosovë.

Më lejoni të theksojë gjithashtu se rritja në sektorin social është në nivel të mirë dhe sigurisht që kemi nevojë ende të mbështesim këtë sektor pasi që dihet shumë mirë që niveli i papunësisë është shumë i lartë dhe varfëria është shumë e madhe dhe duhet bashkarishtë si deputetë të Kosovës të japim kontributin tonë pa marrë parasysh bindjet tona të partive politike, të mbështesim dhe të mundohemi të përmisojmë këtë situatë.

Bedri Hamza – sqaroi se te pjesa e projektsioneve makrofiskale ka ndryshim në raport me buxhetet e kaluara, janë shtuar disa gjëra të reja që sigurisht se ka vend për tu përmisuar por njerëzit që e kanë punuar këtë janë njerëz profesional dhe kompetent. Projektsionet e të hyrave janë bazuar në rritjen ekonomike që është vlerësuar se do të jetë 4.6% dhe brenda mandatit qeverisës do të jetë 5-7%. Parashikimet janë shumë të kujdesshme dhe reale e të mundëshme. Sa i përket trendit të hyrave të hyrat në vitin e kaluar kanë qenë edhe rezultat i masave të reja edhe rezultat i ndryshimit të normave tatimore si dhe si rezultat i ligjit për faljen e borgjeve. Në periudhën e ardhshme nuk kemi ndryshime të normave të TVSH-së, dhe nuk kemi planifikuar të fusim tatime të reja.

Te çështja e projekteve të infrastrukturës pjesa e madhe e projekteve janë projekte në vazhdim dhe janë kontrata ekzistuese dhe nuk munden të ndërprehen pa u përfunduar dhe ministrat e rinjë nuk kanë pasur shumë hapsirë me vendos prioritete të vetat mbrenda buxheteve ekzistuese sepse i kanë kontratat e trashëguara.

Nëse marrim pjesën e madhe të buxheteve të investimeve kapitale, shohim se një pjesë shkon për autostradën drejtim të Shkupit, pjesa tjetër shkon për rrugën Pejë-Prishtinë, një pjesë e rrugës Prishtinë-Mitrovicë pastaj e kemi në drejtim të Podujevës, Gjilanit të cilat janë projekte që ekzistojnë kontratat prandaj nuk ka pasur shumë hapësirë me lëviz dhe unë besoj që këto do të përfundojnë në një periudhë të caktuar dhe do të ketë mundësi që të riorientohen prioritete.

Tek çështja e sigurimeve shëndetësore është një fond kontigjent i vendosur në Ministrinë e Financave pritet që të kompletohen infrastruktura legale, të krijohen të gjitha kushtet për me fillu mbledhja e premiumeve, mirëpo deri sa të fillon mbledhja e premiumeve, ne në anën tjetër e kemi rritur buxhetin e shëndetësisë, kemi rritur numrin e të punësuarve dhe kemi rritur pjesën te barnat esenciale dhe te investimet kapitale.

Sa i përket te çështja e projekteve dhe prioriteteve të caktuara Ministria e Financave ju ka dhënë kufijtë buxhetor organizatave buxhetore, ndërsa prioritete të kanë vendosur ministrat e linjës

Qështja e kategorive të caktuar sociale ne kemi marrë për bazë situatën aktuale me ligjet dhe nëse vazhdohet me reforma unë besoj që mjetet buxhetore do të jenë të mjaftueshëm.

Ne po ashtu kemi reflektuar te buxheti i Forces së Sigurisë së Kosovës tek Ministria e Punëve të Brendshme te AKI-ja.

Sa i përket pyetjes së z.Molliqaj se nuk ka ndryshim me buxhetet paraprake sigurisht se nuk mund të ndodh kur edhe nuk ka me pasur kurr një ndryshim revulocionar po ka ndryshim nëse shikohet në

shëndetësi, arsimit, rendin dhe ligjin janë efekte që janë reflektuar. Sa i përket mjeteve nga AKP-ja janë të specifikuar se ku do të shkojnë mjetet dhe për cilat projekte.

Sa i përket rrugës Deqan-Plavë ne mundemi me diskutu edhe me Ministrin Lekaj nëse ai mendon që duhet të rritet ky fond ai duhet të tregojë edhe para komisionit edhe para Ministrisë të Financave se cilin projekt tjetër duhet me shkurtu për të mbuluar këtë projekt.

Deficiti buxhetor është brenda rregullës fiskale prej 2% ne kemi qenë të kujdesshëm ne kemi shkuar deri në 1.7%.

Te buxheti i komunave e dijmë që tri komuna pa asnjë arsye nuk i kanë aprovuar buxhetet e tyre dhe ne urojmë që të konsultohen asambltet komunale ata mundën të bëjnë buxhetet e tyre mirëpo ne ju sigurojmë te gjithçka që është në përputhje me legjislacionin.

Tek çështja e fondit për veriun është në ligj edhe po ndodh një ndryshim dhe ne jemi të interesuar që të gjitha mjetet e grumbulluara të shpenzohet në përputhje me ligjin, dhe ne nuk vendosim as pengesë administrative as burokratike dhe po kërkojmë me e marrë në konsideratë rekomandimet e auditorit gjeneral.

Sa i përket të hyrave vetanake kisha pasur shumë dëshirë që Universitetet dhe QKUK-ja me pas ma shumë të hyra vetanake dhe kishim mundur të gjejmë konsensusin këtu të gjithë se këto të hyra vetanake t'iu mbesin atyre.

Sa i përket financimit të RTK-së është institucion i themeluar prej Kuvendit dhe kur Kuvendi vepron ndryshe e bën ligjin për RTK-në, ne do ti përshtatemi ligjin. Përndryshe është propozuar buxheti i njëjtë që ka qenë me vitin paraprak, dallimi është se e kemi reflektuar disa diskutime në Komisionin për Buxhet dhe Financa që pas raportimit edhe pjesa e komisionit të jetë dy herë ndërmjet.

Sa i përket tek shpenzimet për mallrat e shërbimeve del një shumë pak më e madhe, por janë rritur kryesisht si rezultat i dy pozicioneve, komunat i kanë rritur shpenzimet për mallrat dhe shërbimet për 18 milionë. Nëse shkojmë nëpër komuna e shohim për disa gjëra elementare kanë vuajtur në mungesë të pozicioneve të mallrave dhe shërbimeve dhe e dijmë që në të kalumen kemi vendosur që të hyrat vetanake komunat kanë të drejtë ti përdorin për qëllimet që ata i vlerësojnë.

Përveç nivelit komunal ka pasur rritje të barnat esenciale për 36 milionë dhe kryesisht rritjet kanë hyrë në specifika të tjera me shtimin e projekteve kapitale dhe mirëmbajtjen e tyre.

Rritja e të punësuarve është për shkak sepse nuk kemi të plotësuar të gjitha pozitat për vitin 2017. Punësimet kryesisht kanë ndodhur tek Shërbimi Spitalor dhe Klinikat Universitare 300 pozita, 169 pozita te Ministria e Punëve të Brendshme, 148 pozita tek Këshilli Prokurial, 112 pozita te Këshilli Gjyqësor të punësuarve.

Sa i përket çështjeve tjera, z.Osmani sinqerisht ju falendërojë shumë për kontributin për diskutimin për këtë çështjen e paradhënies ne e dijmë që bashkarisht e kemi diskutuar edhe më herët kjo 100% paradhënie ka qenë kryesisht për barnat esenciale dhe ju ka lënë në mandatin e Qeverisë që me marr një vendim të këtillë dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, tani le të vendoset në komision a dëshiron me mbet kështu apo mu ndryshu.

Tek pozitat e aprovuara të pa buxhetuara mbulohe me këtë pjesën e dallimit mes buxhetit aprovum dhe shpenzuar.

Tek projektet te komunitetet unë nuk kam problem nëse ministria e linjës vendos kode të caktume për projekte të caktume por tek komunitetet ne kemi biseduar dhe ju falendërojë grupin 6+ ne e kemi vendosur edhe një fond shtesë që është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe gjatë diskutimeve në Komision për Buxhet dhe Financa nëse ka nevojë ai fond të specifikohet me linja konkrete dhe me kode konkrete ne jemi shumë të hapur.

Sa i përket çështjes të biznesave të reja janë ministrit e linjës që kanë fonde me i përkrah bizneset e reja apo bizneset ekzistuese. Lidhur me këtë çështje, po ua jap një informat shtesë, ju e dini që Kuvendi e ka aprovuar Ligjin për fondin e garantimeve të kredive fondi është funksional e ka një kapital aktualisht rreth 20 milionë eurove. Në Kuvend është edhe një projekt marrëveshje me KFW-në e cila është një grant prej 7.5 milion eurove që e rrit kapitalin e këtij fondi. Por ne i kemi filluar negociatat me Bankën Botërore dhe me Bankën Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim e cila ka kushtet më të mira që me

ngritë kapitalin e këtij fondi deri në 50 milionë që krejt në qëllim më i përkrahë bizneset e reja të cilat nuk kanë koleteral nuk kanë historik por kanë fleksibilitet edhe kanë qëndrueshmëri të biznes planeve të tyre.

Mërgim Lushtaku - një çështje realisht që na ka ardhur me u marr edhe kur kam qenë në shërbimin civil kanë qenë që organizatat buxhetore në kohën e pushimit të lehonave me ligj lejohet zëvendësimi i tyre por në aspektin e punësimit për 6 muaj ku planifikohet buxheti nga ministritë e linjës nuk kanë mundësi t'i paguajnë apo ti mbështesin financiarisht. Kështu që unë kisha propozuar që të ketë një kategori apo të bëhet një fond për lehonat, që do të lehtësojë çështjen e kompensimit edhe në arsim edhe në shërbimin civil sipas legjislacionit në fuqi.

Dardan Molliqaj - Ministri, po thotë që nuk mundemi me bo ndryshime revulucionare, por unë mendoj se qfarë kam parë në vendet e tjera edhe në Kosovë se kur ndërrohen qeveritë politike, ndryshimi i buxhetit dallon shumë jashtëzakonisht shumë, por këtu nuk është reflektuar sepse është vazhdimësi dhe unë e kuptoj që një pjesë e përbërë e Qeverisë është e njejta.

Kjo qeveri para dy muajve ka thënë që rritja ekonomike minimumi do të jetë 5-7% pastaj pas dy muajve ka ardhur nën minimum. Sa i përket deficitit unë e di sa e lejon ligji, por rritja e madhe prej 80 në 200 milion euro, është kapërcim i madhë. Sa i përket barnave esenciale jam për sepse gjithmonë kemi problem dhe do të isha dakord gjithmonë me i rrit.

Bedri Hamza – sqaroi se buxheti ka ndryshuar në rritjen e pagave, në rritjen e buxhetit 22% të shëndetësisë, në rritjen e buxhetit prej 26% në arsim, rritjen e reflektimit të rendit të ligjit.

Sa i përket projekteve po e ritheksoj projektet të cilat kanë pasur kontratat nuk ka ndryshuar por kanë vazhduar dhe kanë me u përfundu. Sa i përket deficitit buxhetor po flasim për dy momente, deficitin primar buxhetor është 1.7% e GDP-së më pak se 120 milionë euro. Tek pjesa e klauzolës së investimeve financimi përmes mjeteve të AKP-së është qështje që nuk është pjesë e deficitit primar, prandaj është ruajtur gjithë legjislacioni që ka qenë në fuqi.

Programi i qeverisë për rritje 5-7% por nuk e thotë në vitin e parë por gjatë mandatit është i realizueshëm. Sa i përket qështjes së lehonave janë qështje që janë të rregulluara me ligj dhe organizatat buxhetore janë të obliguara me zbatu ligjin edhe me e njoftë të drejtën e kësaj kategorie.

Dardan Molliqaj – siç po e shoh unë z.Ministër do të duhej që dokumenti i qeverisë që ka qenë të jetë programi i saj ma konzervativ dhe e kundërta me atë me buxhet. E dyta është qështje fushates se nëse dy muaj përpara na bjen një projektim të rritjes dhe zhvillimit përmes një programi qeverisë dhe brenda dy muajve vjen me ndryshime konkrete që ma prek jetën dhe e bjen poshtë kjo është mashtrim sipas mendimit tim. Mbasi jeni aq konservativ në qështjen e buxhetit në rritje por je shumë optimist në deklarime po mendon që këto harrohen që po e thua këtë që mund të jetë 6% te investimet e tjera, nëse është kështu dhe ti je Ministër i Financave pse nuk e ke bërë rritjen 6%.

Bedri Hamza - Z.Molliqaj e ka lexuar dhe po e lexon prapë me kujdes dhe e sheh se që këto që po i them janë të shkruara në buxhet dhe ka konsistencë mes programit të Qeverisë edhe buxhetit të propozuar dhe sa i përket parashikimit për rritjen ekonomike edhe sa i përket prioriteteve të cilat i ka prezantuar Qeveria në programin e saj. E ka vendosur në rend ligjin, shëndetësinë, arsimin dhe janë reflektuar në buxhet. Sa i përket rritjes ekonomike unë si Ministër i Financave gjithmonë mbaj qëndrim që parashikimet për të hyra buxhetore të jenë sa më reale të mundshme dhe ky është një plan që unë besoj që edhe njerëz profesionistë besojnë që e kanë punuar këtë dokument.

Kryetari - Ju faleminderit z.Ministër për atë arsye në fillim të fjalimit tim nëse ju kujtohet e kërkova analizën e sensibilitetit në mënyrë që skenaret e rritjes ekonomike të jenë të lidhura me të hyrat buxhetore. Ne e dimë çka ndodh me të hyrat buxhetore në qoftë se rritja ekonomike shkon 4% dhe çka

ndodh nëse rritja ekonomike shkon me 5%-6% dhe 7%-8%. Unë po ju garantoj dhe e kam lexuar edhe si numër 7% nuk ekziston në pjesën makroekonomike.

Naser Osmani - dua të them edhe një gjë për ty kryetar dhe deputetët e rinjë në këtë komision, zakonisht gjatë elektoratit kemi bërë premtime të mëdha për ngritjen e pagave dhe ka pasur premtime 20-24%. Por me iniciativën e këtij Komisioni dhe me Fondin Monetar Ndërkombëtar një ide që na ka lindur aty për aty e kemi futur në Ligj për Menagjimin e Financave Publike, që qdo rritje e pagave duhet të jetë në propocion me rritjen e GDP-së.

Kryetari – me qenë se Projektligji plotëson kushtet ligjore për shqyrtim në seancë plenare, propozojë që ti rekomandojmë Kuvendit për miratimin në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2018.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni me Gjashtë vota Për, Katër Kundër dhe Asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

I rekomandohet Kuvendit të miratojë në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2018.

4. Të ndryshme

Kryetari - e kemi një kërkesë për transferin e mjeteve buxhetore për RTK-në për periudhën Dhjetor 2017. Ju kujtohet në takimin e 24 Tetorit 2017 ne e kemi shqyrtuar kërkesën e RTK-së për transferin e mjeteve buxhetore për periudhën tetor-dhjetor për tre muaj së bashku me projeksionet e të hyrave dhe shpenzimet për tre muaj dhe ne i kemi aprovuar vetëm për dy muaj sepse rishikimi i buxhetit nuk ka ndodhur atëherë. Tashti ka ardhur kërkesa për muajin dhjetor, e njëjta është dërguar në thesar dhe thesari e ka përcjellur tek ne pasi që kërkohet rekomandim për shumën 1.4 milionë euro.

Projeksionet janë të njëjta sikur se raportimet e mëhershme edhe të hyrat e shpenzimeve dhe pyetja është a kemi nevojë edhe njëherë me i ftue të RTK-së në takim dhe me raportu punën e njëjtë që është bërë apo e marrim një vendim që e kalojmë këtë shumë si jemi marrur vesh në mbledhjen e kaluar.

Naser Osmani - Në parim edhe në bazë të ligjit ne e kemi proceduar, i ka shpenzimet e të hyrat dhe projeksionet për tre muajt e ardhshëm. Me qenë se ata kanë qenë herën e kaluar dhe ne në parim e kemi aprovuar dhe ju z.Kryetari ke mundur pa na pyetur neve me nënshkru dhe është mirë që me korrëksi na ke pyetur edhe neve por kjo qështje është formale dhe është paraparë me ligj shuma e tërësishme. Tashti grupi punes që është ngritur me Dardanin dhe me Mërgimin na ishte dashtur tashti me punu me ata sepse tashti është koha me aprovu buxhetin e RTK-së

Kryetari - ju faleminderit atëherë për korrektësi po e hedh në votim rekomandimin që ti transferohet pjesa e mbetur prej 1.4 milionë.

Pas diskutimeve dhe në bazë të propozimit, kryetari konstatoi se Komisioni me shtatë vota Për, tre Kundër dhe Asnjë Abstenim, nxori këtë

Rekomandim

1. I rekomadohet Ministrisë së Financave, respektivisht drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit, të bëjë transferin e mjeteve buxhetore nga Llogaria e Fondit të Konsoliduar të Republikës së Kosovës, nga buxheti i Radiotelevizionit të Kosovës - kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, në llogarinë e RTK-së nr. 1110101219060187, për periudhën 1 – 31 dhjetor 2017, në shumën prej 1,400,000 (një milionë e katërqind mijë) euro.

Kryetari - qështja e tjetër që desha t'iu njoftojë është se Fondi Monetar Ndërkombëtar ka dërguar një kërkesë për takim në mes Komisionit dhe një mision nga Washingtoni dhe takimi është propozuar të mbahet me 8 Dhjetor në ora 10, kështu që ju ftoj të gjithëve me qenë aty.

Dhe qështja tjetër është që të mos e harroni me 1 Dhjetor në ora 9 nisen punimet në Emerald me GIZ ku është takim pune 1 ditore ku vijnë agjencionet tjera që bëjnë pikërisht shpалosjen e këtyre punëve rreth buxhetit. Nëse dikush ka dëshirë të raportoj për vizitën që keni qenë në Shkup.

Safete Hadërgjonaj - ne kemi qenë në një vizitë në Shkup në një konferencë ku zakonisht këto takime janë mbajtur me vite të tëra me Westminster Foundation ku e kemi pasur të formuar rrjetin e komisioneve për ekonomi dhe financa. Ne kemi pasur pak dilema rreth statusit tonë të cilin e kemi pasur në këtë rrjet dhe unë për mandatin e kaluar nuk kam qenë në rrjedha, dhe ne në mandantin e kaluar kemi qenë anëtarë si vëzhgues kemi pasur dilema por megjithatë kjo qështje me sa kam kuptuar aty është rregulluar dhe tashti jemi të gjitha shtetet e barabarta dhe pjesëmarrja është vullnetare.

Aty është bërë një punëtori ku kemi diskutuar për procedurat buxhetore për kontrollin e financave publike ku ka pasur edhe fokus grupe ku qëllimi ka qenë se secili nga shtetet e rajonit të marrin përvoja nga vendet e ndryshme ku ata kanë bërë mirë të procedurave të buxhetit,ku kanë bërë mbikëqyrjen më të mirë dhe qka ka qenë më rëndësi është analizuar raportet e PEFA-s ku është raportuar mirë nga Komisioni Evropian ku Shqipëria ishte shteti i cili kishte performuar më së miri kurse ne ishim shteti i dytë kurse këto shtetet e tjera të rajonit ishin të ulët se sa na.

Mbledhja përfundoi në ora 13:35

Përgatitur nga Staf i mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lumir Abdixhiku